



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE



PROGRAMI I LËNDËS
Gjuhë frënge specialiteti në biznes dhe turizëm

Ngarkesa: 4 ECTS, 20 orë leksione dhe 20 orë seminare

Viti akademik / semestri kur zhvillohet: Viti III/semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Bachelor në Gjuhë Frënge dhe Gjuhën e Shenjave Shqipe

Kodi i Etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivi i përgjithshëm: Kjo lëndë synon të zhvillojë kompetencat komunikuese, gjuhësore dhe profesionale të studentëve në gjuhën frënge në fushën e biznesit dhe të turizmit, duke i aftësuar ata të komunikojnë në mënyrë efektive me shkrim dhe me gojë në situata reale profesionale.

Objektivat specifike

- Të zhvillojë aftësitë e komunikimit profesional në gjuhën frënge në fushën e biznesit dhe të turizmit.
- Të aftësojë studentët në përdorimin e teknikave të argumentimit, negociimit dhe promovimit të produkteve dhe shërbimeve.
- Të përmirësojë aftësitë e analizës së teksteve ekonomike, profesionale dhe turistike në gjuhën frënge.

Rezultatet e pritshme

Në përfundim të lëndës, studenti do të jetë në gjendje:

- të komunikojë me gojë dhe me shkrim në situata profesionale në fushën e biznesit dhe turizmit;
- të prezantojë, promovojë dhe shesë produkte apo shërbime në gjuhën frënge;
- të analizojë dhe të interpretojë tekste ekonomike, profesionale dhe turistike;
- të mirëpresë, informojë dhe udhëheqë klientë frëngjishtfolës;
- të përdorë strategji komunikimi dhe negociimi në kontekste profesionale;